



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA PËRGJEGJËSE E BURIMEVE NJERËZORE

Nr.4689/3prot.

Gramsh, më 13/11/2024

Lënda: Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak, për lëvizjen paralele në kategorinë e ulët drejtuese, për vendet e shpallura të lira me njoftimin nr.4689, datë 25.10.2024, pozicioni “përgjegjës”, kategoria e ulët drejtuese.

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT ✓

Adresa: Bulevardi “B.Curri” pranë ish-Hotel “Arbana”

TIRANË

Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dokumentacionit dhe verifikimit paraprak, të aplikimeve të dorëzuara pranë zyrës së protokoll-arkivit, për procedurën e lëvizjes paralele në shërbimin civil, për vendet e shpallura të lira me Njoftimin nr.4689, datë 25.10.2024, Njësia Përgjegjëse, Ju dërgon listën e kandidatëve nr.4689/2, datë 08.11.2024 “Rezultati i verifikimit paraprak për lëvizjen paralele në kategorinë e ulët drejtuese (përgjegjës)” që do të nënshtrohen fazës së dytë të konkurimit.

Njoftimi i shoqëruar me shkresë për sa më sipër, do t’ju nisët edhe me E-mail, në adresën: vendetelirapune@akpa.gov.al

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
BESION AJAZI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA PËRGJEGJËSE E BURIMEVE NJERËZORE

Nr.4689/2.prot.

Gramsh, më 08/11/2024

**NJOFTIM MBI REZULTATET E VERIFIKIMIT
PARAPRAK PËR LËVIZJEN PARALELE NË KATEGORINË E
ULËT DREJTUESE (Përgjegjës i Sektorit të Emergjencave Civile dhe
Strehimit)**

**Lloji i diplomës “SHKENCAT EKONOMIKE,” niveli minimal i diplomës “Master
Shkencor”**

Në zbatim të nenit 22 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, të Vendimit Nr. 242, datë 18/03/2015 2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” të Këshillit të Ministrave (i ndryshuar), Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Gramsh në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kushteve të lëvizjes paralele dhe kërkesave të veçanta të shpallura në Njoftimin për konkurrim nr.4689, datë 25.10.2024 “Shpallje për lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranimit nga jashtë në shërbimin civil, kategoria e ulët drejtuese, pozicioni “përgjegjës”, njofton se:

- Nuk ka asnjë kandidat të kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të procedurës;
- Këto pozicione pune janë të vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil.

Afatet dhe mënyra e vlerësimit të kandidatëve që janë të interesuar për fazën e ngritjes në detyrë në shërbimin civil, mbeten të njëjtat me ato të shpallura në njoftimin nr.4689, datë 25.10.2024, të publikuara në Portalin “AKPA”, faqen zyrtare të bashkisë bashkia.gramsh@bashkiagramsh.gov.al dhe në stendën e informimit të publikut bashkia Gramsh.

KRYETARI

BESION AJAZI

